



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, propozon :

Që në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale , nenit 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme nr.2004/18, Ligjit nr.04/L-005 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme dhe neneve 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023, miratoi këtë:

PROPOZIM

RREGULLORE PËR ORARIN E PUNËS TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim ta përcaktojë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2 Fushëveprimi

Me këtë Rregullore përcaktohet orari i punës për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit, detyrat dhe obligimet e pronarëve dhe personave përgjegjës të shoqërive tregtare, mbikqyrjen inspektuese dhe masat administrative dhe ndëshkimore.

Neni 3 Përkufizimet

1.Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. Orari i punës - periudha kohore e fillimit dhe mbarimit të punës.
- 1.2. Lokal afarist-nënkupton objektin apo hapësirën punuese ku ushtrohet veprimtaria.
- 1.3. Person – nënkupton personin fizik dhe juridik
- 1.4. Person fizik nënkupton individin dhe personin fizik si pronar i ndërmarrjes së regjistruar si biznes individual.
- 1.5. Person juridik nënkupton shoqërinë aksionare, partneritetit (shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe komandite), kompaninë e huaj, ndërmarrjen shoqërore dhe ndërmarrjen publike.
- 1.6. Shoqëritë tregtare – nënkupton termin e përgjithshëm që nënkupton çdo lloj të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë tregtare apo ndonjë ligji tjetër duke përfshirë bizneset individuale , ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara , shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare.
- 1.7. Inspektori nënkupton personin zyrtar me autorizim dhe përgjegjësi të veqanta i cili zbaton mbikqyrjen inspektuese
- 1.6. Ditë pune - periudha kohore e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte.
- 1.7. Ditë vikendi - periudha kohore e fundjavës (dita e shtunë dhe e dielë).
- 1.8. Festa zyrtare – ditët të cilat janë të përcaktuara si festa sipas Ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës.
- 1.9 Periudha verore – është periudhë sezonale që fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit kalendarik;
- 1.10. Periudha dimërore – është periudhë sezonale, që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit kalendarik.

II. ORARI I PUNËS

Neni 4

Përmbajtja e orarit të punës

1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.
2. Periudha kohore e fillimit dhe mbarimit të punës caktohet për ditë të rregullta të punës, ditë të punës gjatë vikendeve dhe ditë të punës gjatë festave zyrtare.
3. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës i përcaktuar sipas kësaj rregulloreje, duhet të vendoset në hyrje të objektit apo në pjesë të dukshme ku ushtrohet veprimtaria afariste, duke e saktësuar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës si dhe ditët kur nuk mund të punohet.
4. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në interval kohor:
 - 4.1. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit kalendarik;
 - 4.2. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit kalendarik.

Neni 5

Respektimi i orarit të punës

1. Të gjitha veprimtaritë ekonomike të cilat ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Komunës së Lipjanit janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Të gjitha veprimtaritë ekonomike janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos ndikojnë negativisht në prishjen e qetësisë së banorëve përreth.
3. Të gjitha shoqëritë tregtare janë të obliguara që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre ekonomike të mos bien ndesh me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma, si dhe aktet tjera nën ligjore që rregullojnë këtë fushë.
4. Të gjitha veprimtaritë ekonomike afariste mund të shkurtojnë orarin e përcaktuar të punës të paraparë me kete rregullore. Për punën me të shkurtër, për ditët kur nuk punohet, përveç njoftimit që duhet të vendoset në hyrje të lokalit afarist, paraqitet kërkesë sipas nenit 28 të kësaj rregulloreje përveq në rastet e jashtëzakonshme.

Neni 6

Vendosja e orarit të punës

Të gjithë pronarët dhe personat përgjegjës të subjekteve afariste janë të obliguar që në hyrje të lokalit afarist në vend të dukshëm të vendosin orarin e punës siç është paraparë në këtë rregullore, duke përfshirë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, ditët kur nuk punohet dhe kohën e pauzës në rastet kur praktikohet.

Neni 7

Orari i punës në dyqanet zejtare

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të dyqaneve zejtare:
 - 1.1 Periudha verore prej orës 07:00 deri në orën 20:00
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 deri në orën 19:00
2. Të dielave dhe festave zyrtare nuk punojnë dyqanet zejtare përveç: furrat e bukës, gjelltoret, qebaptoret, fast food, sallonet e ondulimit dhe të zbukurimit.
 - 2.1 Orari i punës në furrat e bukës fillon dhe mbaron:
 - 2.1.1 Periudha verore dhe dimërore prej orës 06:00 deri në 23:00, punojnë çdo ditë të javës.
 - 2.2 Orari i punës në Gjelltoret, qebaptoret dhe fast food fillon dhe mbaron :

2.2.1 Periudha verore fillon prej orës 06:00 -23:00

2.2.2 Periudha dimërore prej orës 07:00 -22:00

2.2.3 Punojnë çdo ditë të javës.

2.3 Orari i punës në Sallonet e Ondulimit dhe zbukurimit dhe veprimtarive tjera ku përfshihet kujdesi personal , fillon dhe mbaron :

2.3.1 Periudha verore fillon prej orës 06:00 -20:00

2.3.2 Periudha dimërore prej orës 06:00 -19:00

2.3.2 Punojnë çdo ditë të javës gjatë sezonës verore ndërsa gjatë sezonës dimërore të dielave nuk punohet.

Neni 8

Orari i punës për veprimtaritë e zyreve të punës, veprimtarive profesionale, shkencore, teknike dhe veprimtaritë tjera ekonomike financiare

Orari i punës për avokat, noter, përmbarues privat, banka, mikrobanka, agjensione turistike, agjensione të patundshmërive, kompani të sigurimeve, zyreve të arkitekturës dhe inxhinierisë , zyreve të analizave dhe testimeve teknike, sportele të pagesave, zyra juridike dhe ekonomike (kontabilist, auditor), zyra të përkthyesve, zyra gjeodezike, këmbimore dhe tjera të ngjashme, gjatë ditëve të javës për periodën verore dhe dimërore është :

1.E hënë - premte fillon në orën 08:00 deri në orën 16:00 .

2.Ditën e shtunë mund të punohet prej orës 09:00 deri në orën 14:00, ndërsa ditën e dielë dhe ditëve të festave zyrtare nuk punohet .

Neni 9

Orari i punës në Qendra tregëtare, dyqane tregtare jo ushqimore, supermarkete dhe dyqane ushqimore

1. Orari i punës në Qendra tregtare , dyqane tregtare joushqimore, supermarkete dhe dyqane ushqimore, do të jetë:

1.1 Periudha verore prej 7:00-23:00

1.2 Periudha dimërore prej orës 8:00-22:00

1.3 Qendrat tregtare, dyqanet tregtare joushqimore ku përfshihen dyqanet tregtare të tekstilit, dyqanet e këpucëve, dyqanet e pajisjeve teknike shtëpiake “teknikës së bardhë, mobishopët dhe veprimtarive të tjera joushqimore” të dielave dhe festave zyrtare nuk punojnë.

1.4 Supermarketet dhe dyqanet ushqimore mund të punojnë çdo ditë të javës siq përcaktohet në paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni përveq ditës së dielë ku orari i punës për të dy sezonat do të jetë prej orës 09:00 deri në ora 14:00 ndërsa festave zyrtare nuk punohet.

2. Në paragrafin 1 të këtij neni nuk përfshihen restaurantet, kafiteritë dhe barnatoret të cilat funksionojnë si pjesë e integruar e qendrave tregtare të tipit miks orari i të cilave rregullohet me dispozitat vijuese të kësaj Rregulloreje.

Neni 10

Orari i punës së barnatoreve farmaceutike

1. Barnatoret farmaceutike, do të punojnë sipas orarit në vijim:
 - 1.1 Periudha verore, prej orës 7:00-22:00
 - 1.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00-21:00
 - 1.3 Të dielave nuk punojnë, përveç barnatoreve që janë kujdestare për atë të dielë
 - 1.4 Pas mbarimit të orarit të rregullt në të dy sezonat orari vazhdohet nga barnatorja kujdestare e caktuar për atë ditë.
2. Për caktimin dhe publikimin e orarit të punës të barnatoreve dhe caktimin e orarit të barnatoreve kujdestare do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i Komunës së Lipjanit.

Neni 11

Orari i punës së ordinancave private mjekësore

1. Ordinancat private mjekësore do të punojnë sipas orarit në vijim:
 - 1.1 Periudha verore, prej orës 7:00-22:00
 - 1.2 Periudha dimërore, prej orës 8:00-21:00
 - 1.3 Të dielave dhe festave zyrtare nuk punojnë.

Neni 12

Orari i punës së barnatoreve bujqësore dhe dyqaneve të produkteve bujqësore

1. Barnatoret bujqësore dhe dyqanet e produkteve bujqësore do të punojnë prej orës 8:00 deri në 19:00 çdo ditë të javës përveq ditës së dielë kur mund të punojnë me orar të shkurtuar prej orës 08:00 deri në ora 14:00;
2. Barnatoret bujqësore, përjashtimisht mund të punojnë jashtë orarit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni në sezonën e mbjelljeve dhe vegjitacionit, me pëlqim paraprak të lëshuar nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, sipas nenit 28 të kësaj Rregulloreje.

Neni 13

Orari i punës në depot e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit

1. Periudha verore prej orës 07:00-18:00
2. Periudha dimërore prej orës 08:00-18:00
3. Ditën e fundjavës (të dielën) dhe gjatë ditëve të festave nuk punojnë

Neni 14

Orari i punës në miniera dhe gurore (industria nxjerrëse)

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te xeheroret dhe guroret tjera (industria nxjerrëse) do të jetë si vijon:

1.1 periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 18:00;

1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

1.3 Orari i punës do të jetë i njëjtë edhe ditën e shtunë ndërsa të dielave dhe festave zyrtare nuk do të punojnë.

Neni 15

Orari punës te Industritë përpunuese

1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te përpunimi i produkteve ushqimore, në periudhën verore fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00 ndërsa për periudhën dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 21:00.

2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i pijeve në periudhën verore fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00 ndërsa për periudhën dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 22:00.

3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i tekstilit, veshjeve, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të lëkurës do të jetë i njëjtë në dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 21:00.

4. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit, të tapës, përveç mobileve; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara, prodhimit të miellit, thurëse, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës dhe shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara, prodhimi i produkteve kimike, prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike, prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës, prodhimi i produkteve minerale jo materiale, prodhimi i metaleve, prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, automekaniket dhe ngjyrosësit e automjeteve, gomisteritë, prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektrike dhe optike, prodhimi i pajisjeve elektrike, prodhimi i makinerisë, prodhimi i makinerive motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove, prodhimi i mobileve, riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve do të jetë i njëjtë në dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 21:00.

5. Gjatë ditëve të vikendit subjektet afariste të cekura në paragrafin 1,2,3 dhe 4 të këtij neni, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar gjatë ditëve të javës (përveq të dielave dhe festave zyrtare që nuk punojnë).

Neni 16
Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore

1.Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë), do të jetë:

- 1.1 Periudha verore prej orës 7:00-18:00
- 1.2 Periudha dimërore prej orës 8:00-17:00
- 1.3 Ditën e fundjavës (të dielën) nuk punojnë

2. Ndërmarrjet ndërtimore në rastet të jashtëzakonshme për shkak të natyrës së punës mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00, duke paraqitur kërkesë sipas nenit 28 të kësaj rregullore.

Neni 17
Orari i punës i ndërmarrjeve për furnizim me ujë, kanalizim, veprimtaritë e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave

Orari i punës te veprimtaritë: furnizim me ujë, kanalizim, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve, trajtimi i mbeturinave dhe asgjësimi i tyre do të jetë i njëjtë në dy sezonet, fillon prej orës 00:00 deri në ora 24:00 (pa ndërprerë). Veprimtaritë e cekura punojnë çdo ditë të javës.

Neni 18
Orari i punës së kafeneve

- 1. Orari i punës së kafeneve do të jetë:
 - 1.1 Periudha verore prej orës 07:00-24:00
 - 1.2 Periudha dimërore prej orës 07:00-23:00
 - 1.3 Punojnë çdo ditë të javës sipas orarit të përcaktuar në paragrafin 1.1 dhe 1.2 përveq ditës së dielë ku orarii punës do të jetë prej orës 08:00-23:00.

Neni 19
Orari i punës në, diskoklube, klube të natës, internet kafe, gaming zone (sony play station etj)

- 1. Orari i punës në diskoklube është i njëjtë për të dy sezonat , fillon në ora 21:00 dhe mbaron në orën 02:00 (të mëngjesit).
- 2. Orari i punës në klubet e natës është i njëjtë në të dy sezonat, fillon prej orës 22:00 dhe mbaron në orën 02:00 (të mëngjesit) përjashtimisht në rast të parashtrimit të kërkesës për zgjatjen e orarit të punës sipas nenit 28 të kësaj Rregulloreje, mund të ju lejohet zgjatja e orarit të punës më së shumti deri në ora 05:00 të mëngjesit.
- 3. Orari i punës për internet –kafe , gaming zone (sony play station etj) fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 23:00 në të dy sezonat.
- 4.Të dielave nuk punojnë.

Neni 20

Orari i punës në hotele, motele, bujtina, restorane dhe salla dasmash

1. Orari i punës në hotele, motele, bujtina, restorane dhe salla dasmash në të dy sezonet fillon prej orës 07:00-24:00, përjashtimisht sallat e dasmave mund të punojnë deri në ora 3:00 (të mëngjesit), sipas kërkesës konform nenit 28 të kësaj Rregulloreje.
2. Hotelet, motelet dhe bujtinat mund të punojnë pandërprerë vetëm me shërbime të fjetjes, mirëpo duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera (restorant, bar, etj) pas orarit të caktuar nga 07:00-24:00.

Neni 21

Orari i punës në pikat e shitjes së derivateve të naftës

1. Orari i punës në pikat e shitjes së derivateve të naftës është i pakufizuar ashtu që të njëjtat subjekte afariste mund të punojnë pandërprerë në të dy periudhat e llogaritjes së kohës sipas sezonave.
2. Restorantet, kafiteritë, shitoret ushqimore që janë nën menaxhimin e pikave të shitjes së karburanteve, mund të punojnë deri në ora 24:00 h.

Neni 22

Orari i punës te Veprimtaritë sportive rekreative

1. Veprimtaritë e sportit dhe të rekracionit punojnë çdo ditë të javës sipas orarit në vijim:
 - 1.1 Në periudhën verore punojnë prej orës 08:00 deri në orën 24:00.
 - 1.2. Në periudhën dimërore punojnë prej 09:00 deri në orën 24:00.
 - 1.3 Për objektet e mbuluara gjatë gjithë vitit vlen orari veror.
 - 1.4 Pishinat e hapura punojnë gjatë sezonit veror me orarin 08:00 deri 21:00

Neni 23

Orari i punës për tregje

1. Tregjet e qytetit do të punojnë vetëm ditën e hënë dhe sipas orarit në vijim:
 - a) Periudha verore – prej orës 07:00-20:00
 - b) Periudha dimërore – prej orës 08:00-19:00

Neni 24

Orari i punës në Institucionet private edukativo-arsimore

1. Orari i punës në Institucionet private edukativo-arsimore që përfshijnë institucionet parashkollore, qendrat për mësim plotësues, kurset profesionale, shkollat digjitale dhe autoskollat do të jetë si vijon:
 - 1.1 Periudha verore prej orës 07:00-20:00

1.2 Periudha dimërore prej orës 07:00-20:00

3.Veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni të dielën dhe festave zyrtare nuk punojnë.

Neni 25

Orari i punës i autolarjeve dhe autoparkingëve

1.Orari i punës në dyqanet që kryejnë veprimtarinë e autolarjes fillon dhe mbaron:

1.1 Periudha verore prej orës 07:00 -20:00

1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00-17:00

2.Autolarjet punojnë çdo ditë sipas orarit të përcaktuar në paragrafët 1.1 dhe 1.2 përveq ditës së dielë që mund të punojnë sipas orarit 09:00- 14:00.

Orari i punës në autoparking fillon dhe mbaron:

2.1.Periudha verore dhe dimërore prej orës 06:00 -24:00

2.2 Punojnë çdo ditë të javës.

Neni 26

Orari i punës për shërbimet automatike

Veprimtaritë ekonomike të cilat ofrojnë shërbime automatike pa praninë fizike të të punësuarve si psh autolarjet vetëshërbyese , bankomatet apo të ngjashme, punojnë 24 orë çdo ditë të javës.

Neni 27

Ruajtja e rendit dhe qetësisë publike

Të gjitha subjektet afariste duhet të jenë të kujdesshme gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre përkatësisht nuk iu lejohe t'u prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Siguri Publike dhe Ligjit për Mbrojtje nga Zhurma.

Neni 28

Procedura për paraqitjen e kërkesës për zgjatjen e orarit të punës

1.Subjektet të cilët kërkojnë leje për vazhdimin e orarit të punës jashtë afatit të caktuar me këtë rregullore, duhet t'i drejtohen me kërkesë organit kompetent, përkatësisht Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim minimum tri ditë para ushtrimit të asaj veprimtarie në ditën zyrtare të punës. Kërkesa për zgjatjen e orarit dorëzohet në Qendrën për Shërbime me qytetarë dhe i drejtohet Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim. Kërkesa duhet të arsyetohet dhe t'i bashkëngjitet kopja e certificates së regjistrimit të biznesit dhe kopja e letërnjoftimit të pronarit të biznesit si dhe dëshmi mbi pagesën e taksës administrative.

Shuma e taksës administrative që paguhet me rastin e aplikimit për zgjatjen e orarit të punës është 5 € (pesë euro).

2. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim është i obliguar të brenda afatit prej prej dy ditësh (ditë pune) të shqyrtoj kërkesën dhe të mar Vendim për lejimin ose refuzimin e kërkesës për zgjatjen e orarit të punës.

3. Të drejtën e tërheqjes apo revokimin e Vendimit për zgjatjen e orarit të punës në rast të prishjes së rendit dhe qetësisë publike apo ankesave të qytetarëve e mban Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim pas marrjes së Kërkesës nga Drejtorati për Inspeksion.

Neni 29

Vendosja e simboleve shtetërore

Të gjitha veprimtaritë ekonomike janë të obliguara që gjatë festave zyrtare të vendosin flamurin shtetëror.

III.DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 30

Inspektimi i respektimit të orarit të punës të veprimtarive ekonomike

1. Inspektori i tregut në bazë të kërkesës së qytetarëve dhe detyrës zyrtare inspekton bizneset lidhur me respektimin e orarit të punës sipas kësaj rregulloreje.

2. Gjatë inspektimit të biznesit, inspektori duhet të inspektojë se a është vendosur njoftimi – publikimi i orarit të punës dhe ditëve kur nuk punohet, në vendin e dukshëm në hyrje të objektit afarist ku shihet dhe se a është në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

3. Ndaj bizneseve që nuk u përmbahen dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektori gjatë inspektimit do të shqiptoj gjoba mandatore sipas dispozitave ligjore.

Neni 31

Gjobat

1. Në rastet kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje, inspektori i tregut duhet brenda afatit 8 (tetë) ditësh kalendarike nga dita e konstatimit të shkeljes të shqiptojë gjobë.

2. Gjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e shqiptimit të tyre.

3. Nëse subjekti i gjobitur bënë pagimin e gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, subjekti lirohet nga pagimi i pesëdhjetë për qind (50%) të shumës së gjobës.

3. Kundër Vendimit të Inspektorit të Tregut për shqiptimin e gjobës pala ka të drejtë ankese në afat prej (30) ditëve në Komisionin për ankesa të komunës. Ankesa kundër vendimit të Inspektorit të tregut nuk e ndalon ekzekutimin e Vendimit.

4. Subjektet afariste që nuk i përmbahen dispozitave të kësaj Rregulloreje ndëshkohen me gjobë:

- 4.1 Personat juridik - prej 300 (treqind) deri në 1,500 (një mijë e pesëqind) euro
- 4.2 Personat përgjegjës të subjektit juridik prej 200 (dyqind) deri në 1,000 (një mijë) euro
- 4.3 Personat fizik – prej 100 (njëqind) deri në 500 (pesëqind) euro
- 4.4 Mosvendosja e orarit të kujdestarisë sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje dënohet me gjobë administrative (100) njëqind euro.

5. Mjetet e mbledhura nga këto gjoba derdhen në buxhetin e Komunës së Lipjanit.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Zbatimi i Rregullores

Për Zbatimin e kësaj Rregulloreje do kujdeset Drejtorati për Inspeksion dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, ndërsa për çështjen e orarit të barnatoreve farmaceutike dhe caktimit të orarit të kujdestarisë do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 33

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Vendimi mbi caktimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.130-59 i datës 30.12.2008.

Arsyetim

Baza ligjore për hartimin e kësaj Propozim -Rregulloreje është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Tregtinë e Brendshme nr.2004/18, Ligjit nr.04/L-005 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.2004/18 për tregtinë e brendshme dhe Statutit të Komunës.

Me Vendim të Kryetarit të Komunës është themeluar Komisioni për hartimin e Projekt-Rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Projekt –Rregullorja përmban 4 kapituj dhe 32 nene.

Te kapitulli i I - Dispozitat e Përgjithshme është përcaktuar :Qëllimi, Fushëveprimi, dhe Përkufizimet.

Te kapitulli i II – Orari i punës është përcaktuar : përmbajtja e orarit të punës, respektimi i orarit të punës, vendosja e orarit të punës, orari i punës në dyqanet zejtare, orari i punës për veprimtaritë e zyreve të punës , veprimtarive profesionale, shkencore, teknike dhe veprimtaritë tjera ekonomike financiare, orari i punës në Qendra tregëtare, dyqane tregtare jo ushqimore, supermarkete dhe dyqane ushqimore, orari i punës i barnatoreve farmaceutike, orari i punës së ordinancave private mjekësore, orari i punës së barnatoreve

bujqësore, Orari i punës në depotë e artikujve ushqimorë, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit, orari i punës në miniera dhe gurore (industria nxjerrëse), Orari i punës te industritë përpunuese, orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore, Orari i punës i ndërmarrjeve për furnizimim me ujë, kanalizim, veprimtaritë e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave, orari i punës së kafeneve, Orari i punës në diskoklube, klube të natës, internet kafe , gaming zone (sony play station etj) , orari i punës në pikat e shitjes të derivateve të naftës, orari i punës te veprimtaritë sportive rekreative, orari i punës për tregje, orari i punës në Institucionet private edukativo – arsimore, orari i punës i autolarjeve dhe autoparkingëve, orari i punës për shërbimet automatike, ruajtja e rendit dhe qetësisë publike, procedura për paraqitjen e kërkesës për zgjatjen e orarit të punës dhe vendosja e simboleve shtetërore.

Te kapitulli i III – Dispozitat ndëshkuese është përcaktuar: Inspektimi i respektimit të orarit të punës të veprimtarive ekonomike dhe gjobat

Te kapitulli i III – Dispozitat përfundimtare është përcaktuar: Zbatimi i Rregullores dhe hyrja në fuqi.

Kjo Propozim - Rregullore ka për qëllim ta përcaktojë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe të aktiviteteve tjera për të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim Rregulloreje.

1Nr. 330/02-18704

Lipjan, më 14.04.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

